

VENDIM
Nr. 438, datë 3.6.2020

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E
RESURSIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE”, TRUALL, TË NJË
SIPËRFAQEJE TË PASURISË ME NUMËR 35, ZONA KADASTRALE 1903,
BASHKIA POGRADec**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për sipërfaqen prej 498.3 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tre) m², pjesë të pasurisë me numër 35, zona kadastrale 1903, fshati Gurras, Njësia Administrative Buçimas, Bashkia Pogradec, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Korçë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga kategoria “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të sipërfaqes prej 498.3 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tre) m², pjesë e pasurisë me numër 35, zona kadastrale 1903, Bashkia Pogradec.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Korçë dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

1458517

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. POGRADEC Zona Kadastrale Nr. 1903
Numri i Pasurisë 35 Volumi 10 Faqe 13
Adresa e Pasurisë GURRAS
Lloji i Pasurisë PEMETORE
Sipërfaqja Totale 9400.00 m2
Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zot (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
REPUBLIKA	E	SHQIPRISE	1/1	TRIANE

- është pronar i pasurisë me numër 35
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V , L , J , P

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuari (t)
më datë 3/2/2017 Nr. 607

Data e lëshimit të çertifikatës
3/2/2017

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI


LEONAT MUSKOLLARI



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT POGRADEC REGJISTRUESI LEONAT MUSKOLLARI <i>[Stampa e Shërbimit të Regjistrimit të Pogradecit dhe nënshkrimi i regjistruesit]</i> HARTOGRAF	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE <u>1903</u> NR. I PASURISE <u>35</u> Vol. <u>10</u> Fq. <u>13</u> INDEKSI I HARTES <u>K-34-114-(88-A)</u> SHKALLA <u>1:2500</u> ADRESA E PASURISE: Rrethi <u>Pogradec</u> Q/E <u>Guras</u> Rr/L. _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____ B. KUFIZIMET C. PRONARI/ET V. <u>34; 36</u> _____ L. <u>285</u> _____ J. <u>288</u> _____ P. <u>282</u> _____ D. Data: 03/02/2017, Ora: _____ REPUBLIKA E SHQIPERISE <i>[Simboli Veri]</i>
---	---



Lidhja nr. 1

Nr. rend	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja në m ²	Sipërfaqja që përdoret për zhvillim m ²	Sipërfaqja ndërtimore m ²	Emërtimi i strukturës
1	Korçë	Pogradec	1903	Gurrës	35	9400	2900	498.3	Inkubator agroushqimor